



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:213554

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610752

P.nr. 55/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu dhe bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të pandehurit E. H., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5853/2023, të datës 14.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 28.03.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Besart Mustafa, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. B. F., me datë 29.03.2024 mori publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

E. H., nga i ati Xh. dhe e ëma B. e vajzërisë S., i lindur më ..., me vendbanim në rrugën “M. D.”, Komuna P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me datë 24.09.2023, rreth orës 20:05, në rrugën “Xh. M.” në P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 2 par. 1.24 të Ligjit për Armët dhe nenin 2 par 1.2 të Udhëzimit Administrativ për armë të ftohta nr. ..., ka mbajtur në posedim armën e mprehtë (...), me hapëse anësore që ka tehur që hapet automatikisht nga shtypja e butonit, në atë mënyrë që gjatë kohës sa ka qenë duke lëvizur me veturë, pasi i njëjti ishte në kërkim me urdhër të gjykatës, i pandehuri ndalohet nga zyrtarët policor dhe gjatë kontrollit në trup tek i njëjti gjejnë thikën të cilën pa autorizim po e mbante në brez.

- me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

II. Me datë 24.09.2023, rreth orës 20:05, në rrugën “Xh. M.” në P., i pandehuri pa autorizim posedon substancë narkotike, në atë mënyrë që përderisa ishte duke lëvizur me veturë ndalet nga policia e Kosovës dhe pasi i njëjti ishte në kërkim me urdhër të gjykatës, në momentin kur zyrtaret policor e kontrollojnë, tek i njëjti gjejnë sasi të dyshuar narkotike e cila pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë rezulton se është e llojit ..., në peshë të përgjithshme prej ... gram.

- me këtë ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48 par. 4, 49, 50, 52, 53, 56 par. 1 nën-par. 1.8 dhe 1.11, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 367 dhe 449 par. 2 nën-par. 2.6 të KPRK-së të pandehurin e:

## G J Y K O N

Për veprën penale si në pikën (I);

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro të cilën detyrohet ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën (II);

II. DËNIM ME KUSHT, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro dhe i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepra tjera penale.

III. Në dënimin me kusht përfshihet URDHRI për përmbushjen e detyrimeve: *“heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës dhe mbajtja e çfarëdo lloji të armëve”*.

IV. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. KONFISKOHEN: ... (..) armë e ftohtë (...) dhe substanca narkotike e llojit ... në peshë të përgjithshme prej ... (...) gram, si mjete të kryerjes së veprës penale.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5853/2023, të dt.14.02.2024, kundër të pandehurit E. H., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.03.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit

dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPPRK-së, të njëjtit i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, ka shprehur keqardhje, është penduar për veprimet e tij, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, nga gjykata ka kërkuar një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase pranimi i fajësisë ka mbështetje në dispozitat ligjore dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurit avokati B. F. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se në konsultim paraprak me të mbrojturin e tij, i njëjti ka pranuar fajësinë, nga gjykata ka kërkuar që si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike të tij, bashkëpunimin me organet e drejtësisë, premtimin e tij se nuk do të përdor substanca narkotike, gjendjen e dobët ekonomike dhe sjelljen e tij në gjykatë, andaj nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal - juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, gjendjen e dobët ekonomike të tij, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh faktin se i pandehuri edhe më parë ka qenë i gjykuar për vepra tjera penale dhe atë sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, PAKR.nr.596/21, data e plotfuqishmërisë 23.11.2021, për veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par. 1 të KPRK-së dhe veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 te

KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) viti dhe dënim me gjobë ne shumën prej gjashtëqind (600) Euro, sipas aktgjykimit te Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.2402/2021, data e plotfuqishmërisë 26.01.2022, për veprën penale “Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 te KPRK-se , i dënuar me dënim me gjobë ne shumën prej dyqind (200) Euro, andaj nga arsyet dhe rrethanat e sipër theksuara vlerëson se dënimi me gjobë dhe dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, apo nuk përmbushë detyrimet e caktuara në dënimin me kusht, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50, 52 dhe 53 të KPRK-së.

Vendimi mbi lëshimin e urdhrit për përmbushjen e detyrimeve është marr ne baze te nenit 56 par. 1 nënpar. 1.8 dhe 1.11 te KPRK- së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të neneve 269 par. 3 dhe 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal  
P.nr. 55/2024, me dt. 23.04.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.